



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 686/5 Prot.

Tiranë, më 10.11.2020

V E N D I M

Nr.142, datë 10.11.2020

“Mbi përfundimin e hetimit administrativ për vlerësimin e ligjshmërisë së aktit nr. 228 prot., datë 21.08.2020, të Kryetarit të Bashkisë Devoll, për lirim nga shërbimi civil të nëpunëses **, si pasojë e dy vlerësimeve periodike të njëpasnjëshme të punës, me rezultatin individual, “jokënaqshëm”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 79 – 90, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e informacionit të protokolluar pranë Komisionerit me nr. 686 prot., datë 16.09.2020, për disa pretendime për paligjshmëri, të ngritura nga ankuesja *****, në lidhje me procedurën e lirimit e saj nga detyra “Specialist Kontabiliteti”, në Sektorin e Menxhimit Financiar, në Bashkinë Devoll, për shkak të dy vlerësimeve periodike të njëpasnjëshme të punës, me rezultatin individual, “jokënaqshëm”,

VËREJ SE:

Nëpunësja *****, nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 686 prot., datë 16.09.2020, ka ngritur disa pretendime për parregullsi dhe shkelje të lejuara në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, gjatë procesit administrativ të lirimit të saj nga detyra “Specialist Kontabiliteti”, në Sektorin e Menxhimit Financiar, në Bashkinë

Devoll, si pasojë e dy vlerësimeve periodike të njëpasnjëshme të punës, me rezultatin individual, “*jokënaqshëm*”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur gjatë hetimit administrativ të çështjes, ka rezultuar e vërtetuar se në momentin aktual, ankuesja është liruar nga shërbimi civil me Vendimin nr. 7, datë 17.06.2020, “*Për lirim nga shërbimi civil*”, të njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Devoll, bazuar në nenin 66, pika “c” të i ligjit nr.152/2013, pas dy vlerësimeve periodike të njëpasnjëshme të punës, me rezultatin individual, “*jokënaqshëm*”, që i përkasin periudhës së gjashtëmujorit të dytë të vitit 2019 dhe gjashtëmujorit të parë të vitit 2020.

Në lidhje me rezultatet e vlerësimit të punës për 6-mujorin e dytë të vitit 2019 (*periudha 01.07.2019-31.12.2019*), rezulton se, ankuesja nuk ka kërkuar rivlerësim dhe as e ka ankimuar atë në rrugë gjyqësore, ndërsa, për vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën 01.01.2020-30.06.2020, konstatohet se, bazuar në Kreun V, të VKM-së nr. 109, datë 26.02.2014, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*” ajo ka kërkuar rivlerësim të rezultateve në punë nga zyrtari autorizues. Ky proces është kryer nga Sekretari i Përgjithshëm në Bashkinë Devoll (*zyrtari autorizues*), i cili me vendim të arsyetuar, ka vendosur lënien në fuqi të vlerësimit “*jokënaqshëm*” të zyrtarit raportues. Vërtetohet se ky vendim i është komunikuar nëpunëses, me aktin nr. 1954/1 prot., datë 17.07.2020, “*Kthim përgjigje*”, të Kryetarit të Bashkisë Devoll.

Në këtë rast vërehet se, procesi i vlerësimit dhe i rivlerësimit të rezultateve në punë për nëpunësen *****, në detyrën “*Specialist Kontabiliteti*”, në Bashkinë Devoll, është realizuar në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil, pasi janë respektuar rregullat e përcaktuara në nenin 62, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe vendimin nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar.

Në këto akte vlerësimi, është bërë analiza e gjithë rubrikave të parashikuara në lidhjen përkatëse dhe janë bërë komente të plota e të qarta nga ana zyrtarit raportues.

Edhe aktorët e tjerë që marrin pjesë në këtë proces, si Zyrtari Kundërfirmues dhe ai Autorizues, kanë shqyrtuar dhe miratuar vlerësimin, gjë që vërtetohet me nëshkrimet e tyre. Për më tepër, në vlerësimin e e periudhës Janar-Qershor 2020, siç u tha dhe më sipër, ka një procedurë të plotë e të rregullt rivlerësimi të konkluzioneve të Zyrtarit Raportues, nga ana e Zyrtarit Autorizues.

Në përfundim të procesit të mësipërm, me të drejtë, njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore me Vendimin nr. 7, datë 17.06.2020, “*Për lirim nga shërbimi civil*”, ka vendosur lirim nga shërbimi civil të nëpunëses *****, në detyrën “*Specialist Kontabiliteti*”, në Bashkinë Devoll, për shkak të dy vlerësimeve negative, të njëpasnjëshme.

Por nga ana tjetër, prej dokumentacionit të dërguar nga Bashkia Devoll, rezulton se ndaj nëpunëses ***** gjatë periudhës së vlerësimit Janar-Qershor 2020, është zhvilluar edhe një ecuri disiplinore, në përfundim të të cilës Komisioni Disiplinor, me Vendimin nr.1138/6, datë 20.05.2020, “ *Për dhënien mase disiplinore*”, ka dhënë masën disiplinore “*Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë dy vjet*”, e cila klasifikohet si shkelje “*e rëndë/shumë e rëndë*”, bazuar në nenet 57 e vijues, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe në Vendimin nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”.

Edhe në këtë rast, pas shqyrtimit të përmbajtjes së dokumentacionit të administruar gjatë zhvillimit të kësaj ecurie disiplinore, konstatohet që veprimet e Komisionit të Disiplinës dhe të njësisë përgjegjëse të Bashkisë Devoll, janë kryer në përputhje me kërkesat e ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, të përcaktuara në Kreun X, “*Disiplina në shërbimin civil*” dhe konkretisht në nenet nga 57 deri në 61, të tij dhe në vendimin nr.115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”.

Ky ndëshkim disiplinor, i shoqëruar me dy vlerësime të njëpasnjëshme negative, ka shërbyer si bazë për njësinë e burimeve njerëzore, që të vendosë përfundimisht, lirimin nga shërbimi civil të nëpunëses *****.

Ndërkaq, gjatë hetimit administrativ të kësaj çështje, është mësuar edhe fakti tjetër, që nëpunësja në fjalë, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshje (*kërkesë padia me nr. 46400898, me datë regjistrimi nr.25.09.2020*) e cila ka filluar shqyrtimin e saj.

Nga sa është parashtruar më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, arrin në përfundimin se bazuar në parimin e sanksionuar në nenin 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, “*Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë*”, sipas të cilit institucionet e tjera nuk mund të trajtojnë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor dhe si pasojë, nuk duhet të vijojë më tej hetimi administrativ, pasi mosmarrëveshja do të zgjidhet përfundimisht nga gjykata, duke rregulluar dhe pasojat e saj.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*”, i ndryshuar, nenin 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996, “*Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar dhe nenin 16, pika “6”, të Rregullores “*Për procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, filluar në bazë të kërkesës nr. 686 prot., datë 16.09.2020, të dërguar nga nëpunësja ******, ku pretendohet në lidhje me disa parregullsi të kryera apo të lejuara në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, gjatë procesit administrativ të lirimit të saj nga detyra në pozicionin “*Specialist Kontabiliteti*”, në Sektorin e Menxhimit Financiar, në Bashkinë Devoll, për shkak se çështja është duke u trajtuar nga gjykata dhe arkivimin e saj.
2. Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Devoll, njësia e burimeve njerëzore të Bashkisë Devoll dhe kërkuesja ******.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha